



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.2023

VENDIM

Nr. 75, datë 13.02.2023

PËR

**MOSFILLIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT ETIK DHE
PROFESIONAL ME QËLLIM PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT
(GRADIMIN), PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016, PËR
GJYQTAREN {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 13.02.2023, si u njoh me materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatorja znj. Yllka Rupa dhe pasi shqyrtoi propozimin për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren {...},

VËREN:

I. FAKTET E ÇËSHTJES DHE PROCEDURA E ZHVILLUAR

1. Në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me shkresën me nr.107/2, datë 19.01.2023 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, protokolluar me nr.250 prot., datë 19.01.2023, është dërguar dosja e gjyqtares {...} Hoxha, së bashku me aktet e vlerësimit profesional, si dhe vendimi nr. 575, datë 19.10.2022 që ka vendosur konfirmimin e saj në detyrën e gjyqtares të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, vendim i cili ka marrë formë të prerë, pasi ndaj tij nuk është ushtruar e drejta e ankimit.

2. Pas shqyrtimit paraprak të dokumentacionit të dosjes së përcjellë nga organet e rivlerësimit kalimtar dhe dokumentacionit të dosjes personale të gjyqtares, ka rezultuar se: Znj. {...} në periudhën tetor 2012 - shtator 2015 ka ndjekur studimet në Shkollën e Magjistraturës. Gjatë kësaj periudhe, nga tetori 2014 deri në muajin gusht 2015 ka zhvilluar stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekretin e Presidentit të Republikës nr. 9655, datë 23.06.2016 ajo është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

3. Sa më sipër rezulton se, gjatë periudhës së vlerësimit tetor 2013-tetor 2016, znj. {...} ka ushtruar detyrën e gjyqtares në dy periudha:

- (i) Praktikën profesionale të vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës nga muaji tetor 2014 deri në muajin gusht 2015, për një kohëzgjatje prej 11 muajsh;

(ii) Funksionin e gjyqtares për periudhën 23.06.2016 deri në datë 13.10.2016, për një kohëzgjatje prej 3 muaj e 20 ditë

4. Pas konstatimeve si më sipër, KVEVP në mbledhjen e datës 07.02.2023 ka shqyrtuar propozimin e relatores së procedurës së vlerësimit dhe ka vendosur të miratojë propozimin për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren {...}, duke ia kaluar për shqyrtim çështjen Mbledhjes Plenare.

5. Në datën 08.02.2023, nëpërmjet postës elektronike, gjyqtares i është njoftuar relacioni mbi projektvendimin “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren {...}”, duke iu njoftuar njëkohësisht: (i) e drejta për të paraqitur kundërshtime/shpjegime me shkrim dhe (ii) e drejta për t’u dëgjuar në Mbledhjen Plenare të Këshillit, duke iu komunikuar data dhe ora e zhvillimit të mbledhjes.

6. Në datën 08.02.2023, gjyqtarja konfirmoi marrjen dijeni, si dhe gjatë këtij afati gjyqtarja nuk parashtroi kundërshtime lidhur me relacionin mbi projektvendimin, si dhe nuk kërkoi të dëgjohej në seancë dëgjimore.

II. KUADRI LIGJOR I ZBATUESHËM

7. Sa i përket periudhës së stazhit profesional aktiv i cili zhvillohej në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, në ligjin i kohës nr.8136, datë 31.7.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 14 parashikohej se: “Formimi fillestar i kandidatëve përfshin një periudhë tre vjeçare që përbëhet nga:

a) Një vit programi teorik me lëndë të ndryshme të së drejtës;

b) një vit praktikë nën kujdesin e një pedagogu të shkollës dhe nën drejtimin e një gjyqtari apo prokurori me kualifikim të lartë;

c) një vit praktik aktiv me ndjekjen e çështjeve më pak të komplikuar nën drejtimin e një gjyqtari ose prokurori (periudha e stazhit profesional).

Programi teorik sipas germës a) të nenit 14 është i përbashkët për të gjithë kandidatët, ndërsa viti praktik dhe viti i stazhit profesional zhvillohen sipas profileve që ka zgjedhur kandidati si gjyqtar ose prokuror..”.

8. Në nenin 19 të po këtij ligji, parashikohej se: “Në përfundim të periudhës së parashikuar në shkronjën “b” të nenit 14 të këtij ligji, sipas vlerësimit të bërë nga këshilli pedagogjik i shkollës, kandidatët për magistratë, sipas profileve të caktuara, caktohen përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtarë dhe prokurorë nga Presidenti i Republikës, me propozimin, përkatësisht, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.” Ndërsa në nenin 19/1 parashikohej se: “Vlerësimi i këshillit pedagogjik bëhet me 5 shkallë: a) shkëlqyeshëm; b) shumë mirë; c) mirë; ç) mjaftueshëm; d) pamjaftueshëm. Rregullat dhe procedurat e vlerësimit përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës.

9. Lidhur me vlerësimin e vitit të tretë, në nenin 20, paragrafi i parë i ligji, parashikohet se : “*Vlerësimi përfundimtar i kandidatëve bëhet nga këshilli pedagogjik, në bazë të rezultateve teorike dhe praktike të stazhit.*” Po ashtu në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, në nenin 27 të saj, në fuqi në momentin kur gjyqtari ka përfunduar stazhin e tij profesional, parashikohet se: “*Pas përfundimit të stazhit para profesional, kandidatët i nënshtrohen stazhit profesional, i cili konsiston në pjesëmarrjen aktive në ndjekjen e çështjeve më pak të komplikuar nën udhëheqjen e një gjyqtari ose prokurori...*”

Në fund të stazhit profesional bëhet vlerësimi i akteve dhe vendimeve të përpiluara nga kandidatët gjatë vitit. Secili prej tyre depoziton dosjen me materialet në sekretarinë shkencore në afatin e caktuar. Ndarja e dosjeve bëhet me short dhe vlerësimi bëhet nga Këshilli Pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës.

Vlerësimi përfundimtar i vitit të tretë bëhet nga Këshilli Pedagogjik.”

10. Sa i përket periudhës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, në nenin 84, pika 1 dhe 2 të Ligjit për Statusin, parashikohet se : “*1. Magjistrati vlerësohet një herë në tre vjet, gjatë pesëmbëdhjetë viteve të para të përvojës profesionale, përfshirë edhe përvojën profesionale si ndihmës magjistrat ose magjistrat i komanduar. 2. Magjistrati vlerësohet një herë në pesë vjet, pas 15 viteve të para të përvojës profesionale si magjistrat..*””. Në vendimin e Këshillit nr. 263, datë 21.11.2019 “Rregulla plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, lidhur me periudhën e vlerësimit, në nenin 5, parashikohet se: “*1. Për çdo gjyqtar përcaktohet periudha e vlerësimit në bazë të viteve të përvojës profesionale sipas parashikimeve të nenit 84, pikat 1 dhe 2 të Ligjit për Statusin....*
2. Periudha e vlerësimit përbëhet nga vite kalendarike dhe fillon në datën 1 janar të vitit të parë të periudhës së vlerësimit.
3. Gjatë periudhës së vlerësimit, tre ose pesëvjeçare, Këshilli vlerëson gjyqtarin, pavarësisht nga koha e ushtrimit prej tij të detyrës, e cila gjithsesi nuk mund të jetë më pak se një vit.”

11. Neni 97, pika 3 i Ligjit 115/2016 “Për organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, parashikon: “*Këshilli i Lartë Gjyqësor zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj.*”. Ndërkohë në nenin 41 të Kodit të Procedurave Administrative parashikohet se: “*Procedura administrative fillon kryesisht ose me kërkesë. 2. Fillimi i procedurës kryesisht është në diskrecionin e organit publik. Organi publik është i detyruar të fillojë procedurën administrative kryesisht kur: a) ligji ose akti nënligjor parashikon fillimin e procedurës; b) situata faktike është e tillë që organi publik duhet të fillojë procedurën administrative për mbrojtjen e interesit publik. 3. Procedura administrative konsiderohet e filluar: a) me kryerjen e çdo veprimi procedural nga organi publik në rastin e procedurës së filluar kryesisht; ose b) me paraqitjen e kërkesës përpara organit publik, në rastin e procedurës së filluar me kërkesë.*

III. ANALIZA LIGJORE E ÇËSHTJES

12. Gradimi i gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, për periudhën vlerësimit 2013-2016, mbështetet në përcaktimet e nenit 171, pika 5 të

Ligjit për Statusin në të cilin parashikohet se: “5. Pas vlerësimit të aftësive profesionale, të kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ose Kolegji i Apelimit, në rast se është ushtruar e drejta e ankimit, i dërgon Këshillit dosjen me vlerësimin e kryer të magjistratit, çdo dokument të përdorur në vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe vendimin e formës së prerë të procesit të rivlerësimit. Nëse magjistrati kalon me sukses procesin e rivlerësimit, **Këshillat vazhdojnë të bëjnë vlerësimin etik dhe profesional të magjistratëve, në zbatim të ligjit, për aq sa është e mundur, me qëllim që të përcaktojnë gradën e vlerësimit përkatës**”. Në referim të këtij neni, analiza dhe konkluzionet e vendimit të formës së prerë të organeve të rivlerësimit kalimtar, konsiderohen të plota në lidhje me burimet që janë analizuar në kuadër të këtij procesi, vetëm në drejtim të qëllimit të identifikimit të gjyqtarëve që kanë arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Shkalla e kësaj aftësie në nivelet: “Shkëlqyeshëm”, “Shumë mirë”, “Mirë” apo “Mjaftueshëm” përcaktohet në procesin e gradimit, pavarësisht konkluzioneve të organeve të vlerësimit lidhur më të.

13. Dispozita e mësipërme detyron Këshillin të bëjë gradimin e gjyqtarëve sipas Ligjit “Për Statusin”, **vetëm nëse në zbatim të ligjit, ky vlerësim është i mundur**. Me termin “Ligj” do të kuptohet jo vetëm Ligji për Statusin, por edhe Ligjet e tjera që afektojnë për shkak kompetence të organit, gradimin e gjyqtarëve, sikundër është Ligji nr.8136, datë 31.7.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili për periudhën tetor 2014 deri në muajin gusht 2015, përcaktonte si organ kompetent Shkollën e Magjistraturës, për të bërë vlerësim etik dhe profesional për gjyqtarët në vitin e tretë të programit të formimit fillestar.

14. Referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor të kohës, konkretisht neneve 14, 19, 19/1 dhe 20 të ligjit nr. nr.8136, datë 31.7.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 27 të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, rezulton se periudha e stazhit profesional e cila zhvillohej gjatë gjithë vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës, ka qenë pjesë integrale e Programit të Formimit Fillestar dhe për pasojë, vlerësimi i veprimtarisë së gjyqtarit gjatë kësaj periudhe të ushtrimit të detyrës, i është nënshkruar vlerësimit profesional nga Shkolla e Magjistraturës, në kuadër të vlerësimit përfundimtar të kandidatëve, në përfundim të programit të formimit fillestar. Për pasojë, kjo periudhë e veprimtarisë profesionale nuk mund të bëhet objekt i një vlerësimi të dytë etik dhe profesional nga ana e Këshillit, pavarësisht se gjyqtarja Hasantari e ka pasur statusin e gjyqtarit edhe gjatë praktikës profesionale.

15. Vlerësimi etik dhe profesional që bëhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për një periudhë të caktuar vlerësimi, nuk mund të mbivendoset me vlerësimin që bën vetë Shkolla e Magjistraturës, për të njëjtë periudhë vlerësimi, për kandidatët e vitit të 3-të Shkollës së Magjistraturës, për shkak se edhe pse për të njëjtën periudhë, kandidati i vitit të 3-të sipas ligjit të kohës, ka pasur statusin e gjyqtarit, i vetmi organ që ka pasur kompetencën e vlerësimit etik dhe profesional të tij ka qenë Shkolla e Magjistraturës,

vlerësim mbi të cilin është bërë edhe pikëzimi dhe renditja e tij me rastin e diplomimit nga kjo Shkollë.

16. Lidhur me periudhën e ushtrimit të detyrës, pas emërimit të znj. {...}, në përfundim të programit të formimit fillestar, në raport me periudhën 3-vjeçare të vlerësimit 2013-2016, rezulton se ajo ka ushtruar detyrën pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, për periudhën 23.06.2016 deri në datë 08.10.2016, për një kohëzgjatje prej 3 muaj e 15 ditë. Edhe nëse viti 2016 do konsiderohej vit i plotë pune për efekt të periudhës së vlerësimit, kohëzgjatja efektive e detyrës së gjyqtares përkon me me 6 muaj e 7 ditë.

17. Në zbatim të nenit 41 të K.Pr.Administrative që rregullon rastet dhe mënyrën e fillimit të një procedimi administrativ, në lidhje me nenin 171 pika 5 të Ligjit “Për Statusin”, procedura administrative me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit për gjyqtarët e konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë, fillon nga Këshilli në mënyrë të detyrueshme sipas ligjit, në rast se plotësohen në mënyrë kumulative kushtet e mëposhtme:

- 1) Gjyqtari të ketë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, duke u konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë;
- 2) Periudha e stazhit profesional pranë Shkollës së Magjistraturës të mos përfshihet në kohën e punës si gjyqtar;
- 3) Koha/periudha e punës si gjyqtar me qëllim gradimi të jetë jo më pak se një vit.

18. Gjykata Administrative e Apelit, në vendimin nr.86, datë 07.12.2022, vendim i cili ka rrëzuar padinë e gjyqtarit G.M, duke pranuar arsyetimin e Këshillit për pamundësinë në objekt e qëllim të procedurës së gradimit të filluar për këtë gjyqtar, ka arsyetuar se: *“.....kalimi me sukses i procesit të rivlerësimit kalimtar/vetting nga gjyqtari G.M, përbënte rrethanë të pamjaftueshme për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional/vlerësimit periodik, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit/gradimin, përsa kohë që nuk plotësohej edhe një tjetër kusht, ai i përvojës së punës/kohës së ushtrimit të detyrës si gjyqtar, jo më pak se një vit”*. Gjykata e Apelit Administrativ konfirmon qëndrimin e Këshillit se kalimi me sukses i procesit të rivlerësimit kalimtar/vetting nga një gjyqtar, nuk e bën të pazbatueshme pengesën e parashikuar në nenin 5/4 të Vendimit nr. 263 dt. 21.11.2019 “ Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

19. Në rastin konkret, me konstatimin paraprakisht të mungesës së kushteve për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, sipas parashikimeve të nenit 171/5 të Ligjit për Statusin, për gjyqtaren {...}, Këshilli vlerësoi se procedura e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtares për periudhën e vlerësimit 2013-2016, nuk mund të fillonte, në kushtet kur koha e ushtrimit të detyrës që përfshihet në periudhën e vlerësimit 2013-2016, e cila përbën periudhë të plotë vlerësimi në kuptim të nenit 84 dhe 171/5 të Ligjit për Statusin, është më e shkurtër se një vit, sipas përcaktimeve të nenit 5, pika 4 të vendimit nr. 263, datë 21.11.2019. Përcaktimi i këtij kufiri kohor minimal 1/vjeçar, është miratuar nga Këshilli,

për të mundësuar kryerjen efektive të vlerësimit me të dhëna dhe materiale të nevojshme për vlerësim (burime vlerësimi).

IV. KONKLUZIONI

20. Sa më sipër, në kushtet kur gjyqtarja pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës, nuk rezulton të ketë ushtruar funksionin e gjyqtares për një kohëzgjatje minimale prej një viti brenda periudhës së vlerësimit 2013-2016, procedura e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtares {...} nuk mund të fillojë, pasi gjyqtarja nuk ka ushtruar detyrën e gjyqtares për një kohë të mjaftueshme gjatë periudhës së vlerësimit, për të mundësuar vlerësimin e saj etik dhe profesional.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a” dhe “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 85 dhe 171 pika 5 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 61 pika 1, 63 dhe 86 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenin 41 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, dhe Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016.
2. Një kopje e vendimit t’i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR